



Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

RELACION

PËR

VENDIMIN

PËR

CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARIN E TRETË DHE TË KATËRT GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Neni 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator ose KAS-it.

Në zbatim të nenit 96, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimit nr. 5, datë 16.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV”, të ndryshuar, jo më vonë së 30 ditë para datës së zgjedhjeve, organizon në seancë publike hedhjen e shortit, ndërmjet partive politike, për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe katërt të GNV-ve.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë së është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Qëllimi i këtij projektvendimi është caktimi i anëtarëve të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024.

Për caktimin e partive politike që fitojnë të drejtën për të propozuar anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV, Komisioneri bazohet në përcaktimet e Kodit Zgjedhor, konkretisht;

- Nenin 95, pika 2, parashikon se anëtari i tretë propozohet nga partitë politike të shumicës parlamentare dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të këtij Kodi;

- Neni 96, pika 1, parashikon partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ nëpërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive politike të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak së dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë.

Nëse asnjë nga partitë politike që kanë të drejtë propozimi të anëtarit të tretë dhe të katërt nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar nga ky nen, e drejta e propozimit i kalon, sipas rastit, partisë politike që propozon kryetarin ose zëvendëskryetarin e KZAZ-së brenda të njëjtit grupim politik.

Referuar shkresës së Kuvendit të Shqipërisë nr. 259/1 prot., datë 24.1.2022, partitë parlamentare janë si vijon:

Shumica parlamentare

1. Partia Socialiste e Shqipërisë:
74 mandate në Kuvendin e Shqipërisë

Pakica parlamentare

1. Partia Demokratike e Shqipërisë “Aleanca për Ndryshim”:
59 mandate në Kuvendin e Shqipërisë
2. Lëvizja Socialiste për Integrim:
4 mandate në Kuvendin e Shqipërisë
3. Partia Socialdemokrate:
3 mandate në Kuvendin e Shqipërisë

Në zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Himarë që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024, janë regjistruar nga KQZ këto parti politike:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë,
2. Partia Republikane Shqiptare,
3. Partia Demokristiane e Shqipërisë,
4. Partia Fryma e Re Demokratike,
5. Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut,
6. Partia e Lirisë,
7. Partia Balli Kombëtar,
8. Partia Demokratike,
9. Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë,
10. Partia Balli Kombëtar Demokrat,
11. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar,

Nga lista e subjekteve të regjistruara në KQZ si subjekte zgjedhore rezulton se parti e shumicës parlamentare është vetëm Partia Socialiste e Shqipërisë

Në kushtet kur asnjë nga partitë politike që kanë të drejtë propozimi të anëtarit të tretë që propozohet nga partitë politike të shumicës parlamentare nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar nga neni 96 pika 1/1, e drejta e propozimit i kalon, partisë Socialiste të Shqipërisë si partia politike që propozon zëvendëskryetarin e KZAZ-së brenda të njëjtit grupim politik.

Nga lista e subjekteve të regjistruara në KQZ si subjekte zgjedhore rezulton se parti të pakicës parlamentare janë:

1. Partia Demokratike
2. Partia e Lirisë

Partia Demokratike: Edhe pse është një parti opozitare dhe ka fituar disa mandate në zgjedhjet pararendëse, nuk plotëson kushtin për të propozuar anëtarin e katërt të GNV për këto zgjedhje. Kjo për shkak të kriterit të përcaktuar në nenin 96, pika 1, sipas të cilit partitë politike parlamentare që propozojnë kryetarin ose zëvendëskryetarin e KZAZ-se nuk janë pjesë e shortit. Në këtë rast PD ka propozuar kryetarin e KZAZ-së 88 dhe rrjedhimisht nuk plotëson këtë kriter.

Partia e Lirisë: Plotëson kushtin e përcaktuar nga neni 96, pika 1/1, pasi ka fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse dhe është regjistruar si subjekt zgjedhor për këto zgjedhje.

Në kushtet kur nga partitë politike që kanë të drejtë propozimi të anëtarit të katërt që propozohet nga partitë politike të pakicës parlamentare kushtin e përcaktuar nga neni 96 pika 1/1, e plotëson vetëm Partia e Lirisë.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për caktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024”.

Erion Meta	- Drejtorja e Administratës Zgjedhore
Madalena KOJA	- Drejtorja e Ligjshmërisë
Majlinda ÇELMETA	- Sekretari i Përgjithshëm (në mungesë dhe me autorizim)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

protdate

Nr.

protnumber

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

V E N D I M

P Ë R

**CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARIN E TRETË
DHE TË KATËRT GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, PËR ZGJEDHJET E
PJESHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, germa “n” dhe 2, nenit 95, pika 2, nenit 96, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi dëgjoi përfaqësuesit e partive politike në KQZ;

V E N D O S:

1. “Partia Socialiste e Shqipërisë” ka të drejtën e propozimit të anëtarit të tretë të Grupeve të Numërimit të Votave.
2. “Partia e Lirisë” ka të drejtën e propozimit të anëtarit të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: dd mm vvvv Nr:
Ora: hh:mm



Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024”